

Ndikimet e Përmbajtjeve Audiovizive tek Publiku-Dhuna në Television

Received: 04.03.2025 / Accepted: 20.03.2025 / Published: 29.04.2025

© 2024 Suela MUSTA

Doi: <https://doi.org/10.5281/zenodo.15303279>

Abstrakt

Televizioni vazhdon të ruajë një nivel epërsie si medium masiv, edhe në kulmimin e platformave të rrjetit. Misioni i televizionit, përtej funksionit si industri biznesi, fokusohet tek informimi, edukimi dhe argëtimi i publikut. Ekranit vazhdon të mbërthejë pas vetes breza të ndryshëm në Shqipëri, ndërkohë që shijet e audiencave janë të ndryshme. Në këtë aspekt, studimi i përmbajtjeve audiovizive merr një rëndësi specifike për të konstatuar efektet e drejtëpërdrejta dhe të tërthora që krijojnë te publiku. Sociologu i njohur i komunikimit Pierre Bourdieu theksonte faktin se në vitet 90' ndryshoi kursi i funksionit të televizionit. Programet e transmetimit, u fokusuan nga tematika me natyrë kulturore (Bourdieu, 1996), çka karakterizonte fillimet e tij, në ato programe që synonin të plotësonin shijet e publikut.

Dhe një nga tendencat që u shfaq në fakt që në vitet '60 ishte prezenca e dhunës në filma, edicionet informative dhe emisione të ndryshme, me qëllim për të rritur audiencën. Një nga ndikimet më të ndjeshë që ka në public televizioni, prodhohet pikërisht nga dhuna në programet audiovizive. Në këtë studim fenomeni nuk trajtohet vetëm nga pikëpamja e cënimit të normave të etikës në përmbajtjet televizive, por edhe me gjerë.

Studiuesit e komunikimit, sociologjisë dhe psikologjisë po e përcjellin herë pas herë alarmin e efekteve të dhunës në media vecanërisht tek pasojat që shkaktojnë imazhet tek të rinjtë dhe adoleshentët. Nga monitorimet e kryera në edicionet e lajmeve dhe programme të ndryshme rezulton se dhuna pasqyrohet në dy drejtime kryesore: në tekst ashtu edhe në imazhet e përmbajtjeve televizive.

Ky studim përfshin dhe të dhënat e nxjerra nga monitorimi i disa programeve në televizionet kombëtare private sikurse janë Klan Tv, Top Channel dhe Vizion plus, të përzgjedhur për shkak të audiencës së lartë që i ndjek ato.

Fjalë kyçe: *dhuna, audience, media audiovizive-television, programacion, lajme, kodi i transmetimit, teori e kultivimit.*

¹ Lecturer at Beder University, Department of Communication Studies, Email: smusta@beder.edu.al

1.1 Media dhe dhuna. Dhuna në media

Dhuna dhe pasoja e saj të drejtëpërdrejta ose derivuese në shoqëri kane qenë përherë pjesë e pasqyrimin në media si asaj të shkruar (gazeta), elektronike (radio televizion) dhe tashmë online. Nga ana tjetër ky dualitet media dhe dhuna shtjellohen kohë pas kohe jo vetëm në funksion të informimit publik, por dhe interesit të medias për ta shfrytëzuar këtë tipar të njeriut si element marketingu për të shitur hapësira mediatike. Përvec informimit si mission kyç i medias, dhuna ka gjetur hapësirë dhe në funksionet tjera të kësaj industrie sikurse janë argëtimi apo në programet e argëtimit dhe showbizz.

Studiues të ndryshëm e shpjegojnë këtë orientim të mediave drejt dhunës, nga imponimi shijeve të audiencës (Gerbner, G., Gross, L., Morgan, M., & Signorielli, N. (1980). Ndërkohë shkolla teorike të media komunikimit, përmes cilësimit të hegjemonisë së audiencës shpjegojnë se, emisionet dhe programet që përmbajnë dhunë shesin më tepër produktin mediatik, pra, sjellin më shumë para për zyrat e marketingut dhe reklamës së mediave. Duke iu referuar fokusit të këtij studimi që janë televizionet kombëtare vihet re se në programme televizive që ka një rritje shqetësuese të thyerjes së parimeve të Kodit të Transmetimit, (kodit të etikës që funksionon për tv dhe radiot)².

Sipas të dhënave zyrtare të AMA-s në vitin 2023 pjesa më e madhe ankesave drejtuar KA kishin të bënin me cënimin e të drejtave të njeriut dhe të komunitetit në tërësi (Kodi-I-Transmetimit. 2020). Nga 390 ankesa të depozituara, 59,5% përfshinin publikimin e informacionit dhe të imazheve që cënonin dinjitetin dhe të drejtat e njeriut, ku përfshiheshin dhe elementët e dhunës.




Figura nr. 1. Përmbajtja mediatike e ankesave drejtuar KA për vitin 2023

2.1 Disa teza teorike mbi dhunën në përmbajtjet mediatike

Për studiuesit e televizionit është e rëndësishme të përcaktohet raporti i ofertës së përmbajtjes me kërkesën e shijeve të audiencës. Konteksti i ekspozimit të programeve në television para audiencave të ndryshme, është një çështje që duhet konsideruar gjerësisht nëpër studimet e ekspertëve (Appel, 2008).

Hipoteza e kultivimit, natyrisht, nuk pretendon se është shikimi i televizionit në vetvete ai që shkakton ndryshim, (Jan Van den Bulck, 2004) është përmbajtja e dhunshme në stacionet televizive, që u tregon shikuesve histori për botën reale.

Pasqyrimi i dhunës mendon Appel mund të krijojë ndjesitë e frikës dhe të ankthit në shumë kategori shikuesish të cilët pas konsumit të kohës në television, e shikojnë botën si një mjedis aspak të sigurt dhe të pajetueshëm. Madje, shumë prej tyre ndërmarrin akte dhune duke e legjitimuar atë si mbrojtje dhe si të justifikueshme, pasi këtë e kanë parë në ekran.

2.1.1 Teoria e Kultivimit

Një nga teoritë më klasike të trajtimit të dhunës në ekranet televizive dhe që bazohet në konceptin e homogjenitetit të përmbajtjes është teoria e kultivimit (Gerbner, Gross, Morgan, & Signorielli, 1980).

Sipas kësaj teorie përsëritja e të njëjtave tematika në programe të ndryshme krijon shikues, publikë aktivë. Këta të fundit krijojnë eksperiencat dhe pikëpamjet e tyre përmes ndjekjes së programeve. Në këtë prizëm konsiderohet dhe efekti i dhunës që është i pranishëm në shumë filma, kronika televizive, videoklipe, programme *shoewbizz*-i etj.

Teoria e kultivimit përfaqëson idenë se perceptimet e njerëzve mbi botën reale ndikohen në mënyrë të pandërgjegjshme nga konsumi që, ata i bëjnë programeve mediatike.

Megjithatë, ekziston një çekuilibër midis sasisë së dhunës së përshkruar në media dhe sasisë që ndodh në jetën reale. George Gerbner, prezantoi *Teorinë e Kultivimit* “si një sistem shpjegimi në nivel makro për mediat masive”. Termi “Teoria e Kultivimit” u krijua për herë të parë nga George Gerbner, i cili ndikoi shumë në Teorinë e Komunikimit. Pikëpamjet e tij u shpallën rreth viteve ’60-të, në kohën kur në SHBA, për shkak të ndikimit të programeve televizive, niveli e dhunës ishte bërë çështje e politikës së ditës. Gerbner kreu analizën e të dhënave të marra nga programet, nga e cila rezultoi se mediumi i tv ishte burim kryesor i shfaqjeve të dhunës.

Në studime dhe raporte të ndryshme të ekspertëve mbi përmbajtjet me elemente të dhunës në programet audiovizive theksohet se “Mediat raportojnë vetëm anën ‘spektakolare’ të dhunës.” Këto raportime nuk thellohen as në investigimin e shkaqeve dhe as në analizën e tyre. Një gazetari e mirë bën edhe analizën e asaj që ka ndodhur, natyrisht duke e ruajtur analizën në kufijtë e mundshëm të objektivitetit. Deri tani dhuna në familje është shndërruar në pjesë të vogël të debatit publik, por ajo dominon hapësirën mediatike.

Sociologu Gëzim Tushi vë theksin tek mungesa e normave të etikës në trajtimin e lajmeve mbi dhunën (Intervistë, 2023). Në një nga pronocimet e tij televizive ai thekson se:

[...] në media është e vështirë të aplikohet teoria e distancës, sepse media nuk është sociologji dhe kërkon lajm. Duhet një kostum etik, përgjegjësi publike, ka shumë detaje në përshkrimin e vetëvrasjeve dhe këto nuk i hyjnë në punë publikut. Raportimi, trajtimi i kriminalitetit si vrasjet ose vetvrasjet, sjellin deformim në edukimin e njerëzve. Nxitimi në emër të kapjes *prime time/ audimetrin* sjell që të jipen konkluzione të nxituara që jo vetëm nuk i bëjnë mirë publikut, por e dëmtojnë opinionin. Në botimet e mia mbrojt tezën se veprimet e nxituara të medias janë ilaçi më i keq për sëmundjen e dhunës që e ka kapur shoqërinë (Tushi, Intervistë, 2023).

3.1 Monitorimi i përmbajtjeve televizive

Monitorimi i përmbajtjeve televizive është një nga temat kyçe të studimeve mbi botën e televizionit. Prej mëse një dekadë studiuesit e mediave orvaten të gjejnë [paradigma të reja në ndikimin që ka sot televizioni në hapësirën publike ku audiencat kanë gjetur më së shumti veten tek rrjetet sociale. Nga ana tjetër konvergimi i përmbajtjeve televizive në platformat e informimit digjital si p.sh. *web youtube* apo mediat sociale, e bën edhe më sfidues përcaktimin e tezave të studimit të përmbajtjes. Autorë si Candell (Candell, Sarah 2007). theksojnë se leximi literalisht i kontetit (përmbajtjes) ka për qëllim jo të kuptojë më shumë mbi televizionin si medium cilësor, por si një dobishmëri për publikun. Autorë si Schwaab (2013) mendojnë se njohja e cilësisë së përmbajtjes televizive është çështje e promovimit të programeve të dedikuara për audiencën. Në focus janë kronikat sociale dhe kronikat e zeza që transmetohen në edicionet qendrore të lajmeve në televizionet private kombëtare Klan, Top Channel, Vizion Plus, si dhe ai publik RTSH. Përsa i përket televizioneve lokale është përzgjedhur News 24 si televizion me kontribut dhe traditë të hershme në hapësirën mediatike në vend, me audiencë të lartë si dhe referuar kritereve ligjore të përcaktuara në Ligjin për Transmetimet audiovizive 2013, i ndryshuar dhe posaçërisht në Kodin e Transmetimit.

Duke qenë se edicionet e lajmeve, sipas ekspertëve të media-komunikimit përcaktojnë një ndër dimensionet më të ndjekur të prodhimeve televizive, mbetet për t'u theksuar se pikërisht ndër informacionet që kanë më shumë impakt për publikun, janë kronikat e zeza. Janë marrë në monitorim përmbajtja e kronikave të zeza në lajme për arsye se studiues të shumtë të shkollave të psikoanalizës dhe sociologjisë së komunikimit kanë vënë theksin tek rëndësia e mesazheve dhe imazheve që jepen përmes medias dhe posaçërisht programeve televizive. Madje disa prej tyre kanë mbrojtur tezën e psikopatologjisë së programeve televizive³ *Marco Nicastrò 2019*)

Pak më sipër tek pjesa e studimit që pasqyron modelet teorike dhe ekspertizës së shkollave psikologjike, u theksua se, dhuna, përplasjet verbale (*hate speech*) ajo fizike, vrasjet, aksidentet apo cdo ngjarje e këtij lloji, krijojnë premisa të forta për sëmundje dhe probleme të shëndetit mendor si ankth, frikë, obsesione, trishtim i thellë depresion, pse jo

³

duke cuar individë të caktuar deri në vepra kriminale, përritje të atyre afarë shohin në Tv, ose vetëlëndim etj

Përmbajtje të caktuara të transmetimeve televizive ndikojnë në gjendjen psikosomatike të individëve në public që lidhen me depresionin, vetëizolimin, pagjumësinë, oreksin ushqimor varësinë nga alkoli, pornografia dhuna etj

Nga ana tjetër kategori të publikëve të ndryshëm ndikohen dhe në mentalitetin socialkulturore të tyre nga nga imponimi mendësive dhe sjelljeve që përcillen në media dhe në rrjetet sociale(Cambridge journals, 2022) ⁴. Efektet që krijohen në psikozën e individit kanë të bëjnë më së shumti me ankthin, shpërqëndrimin dhe dilemën për gjetjen e identitetit në këtë përplasje qëndrimesh dhe idesh në hapësirat mediatike audiovizive dhe asaj online.

3.1 Analiza mbi disa gjetje të monitorimeve nga përmbajtjet audiovizive.

Kronikat që janë përfshirë në rezultat e monitorimit janë konsideruar si ndikuese tek mendësia e publikut⁵ Përzgjedhja është bërë bazuar dhe mbi elementët që sanksionon Kodi i Transmetimit, citoj pikat 2.7, 2. 8, 2. 9, 2, 12 dhe më tej 3.15, 3, 16, 3.18.⁶

Përsa i përket indikatorëve të monitorimit të lajmeve, bazohemi më ato sasiorë cilësorë dhe të kombinuar. Monitorimi me tregues sasiorë i referohet elementit të numrit të kronikave të zeza dhe ato me tematikë sociale(përfshirë dhe mbi shëndetin) brenda një edicioni informativ Monitorimi sipas indikatorë cilësore lidhet me dy elementë kyç të transmetimeve audiovizive që ndikojnë tek publiku

A – Përmbajtja – Teksti informativ i kronikës së zezë që dëmton drejtpërsëdrejti shëndetin mendor. Nga monitorimi rezulton se shumica e kronikave janë ndikuese për shëndetin mendor të audiencës nga elementi i përmbajtjes së tekstit, apo sinkroneve që jepen përmes intervistave të personazheve të ngjarjes.

⁵ Këto kronika konsiderohen të tilla për shkak të përmbajtjeve sensitive të informacioneve që përcillen mbi vrasje, vetvrasje, aksidente, plagosje, kanosje, dhunës në familje, mes të rinjë, me natyrë seksuale, përplasjeve civile, dhuna online në Internet, fenomene natyrore me pasoja të rënda si zjarre, përmytje, sëmundje epidemike, etj

Informacione të hollësishme për rrethana vrasjesh, plagosje apo detaje të tepërta në përshkrimin e ngjarjeve, krijojnë intensitet ndjesor tek publiku.

Imazhet, pra pamjet vizuale dhe përmbajtja audio p.sh. të qarat e të afërmeve, ose të fëmijëve, mesazhet e rënda, bëjnë që shikuesit të përqendrohen tek e ndjeshmja dhe të shmangin apo të zbehin analizën e mesazhit që jepet. Në këtë kontekst rolin e stimuluesit emocional deformues të mendimit kritik e luajnë shfaqja në ekran e shantazheve kërcënime ndaj të afërmeve të viktimave në ngjarje me vrasje, apo dhuna fizike.

Këto drejtime të monitorimit të përmbajtjes audiovizive janë dhe shtyllat kryesore të punës në AMA, së cilës, ndër të tjera, i referohen dhe për sanksionet që institucioni ndërmerr ndaj OSHMA

Transmetime që nxisin dhunën ose vepra penale; Transmetime që cenojnë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut; Transmetim i përmbajtjeve të dëmshme për fëmijët & Transmetime të paligjshme në internet (Top-Channel TV, 2024).⁷

3.3 Monitorimi i përmbajtjes së lajmeve

Nga monitorimi i kronikave të lajmeve, kuptohet se informacionet që ndikojnë tek shëndeti mendor i publikut janë: vrasjet, aksidentet me viktima, vetëvrasjet, vrasjet brenda familjes, dhuna ndaj grave, fëmijëve dhe të moshuarve, ngacmimet dhe përplasjet e dhunshme në rrjetet sociale,

Muaji Gusht 2024

Televizionet	Numri I kronikave të zeza me impact ndjeshëm në public ⁸	Teksti – I kronikës + sinkroni (me përmbajtje dhune- ndikuese	Imazhe audio-vizuale (me përmbajtje ndikuese
--------------	---	---	---

⁷<https://top-channel.tv/2024/08/07/27-gjoba-per-7-muaj-kryetarja-e-ama-s-ben-publike-llojet-e-shkeljeve-te-kryera-nga-televizionet/>

⁸ Idem 4

		)	
Top Channel	19	12	7
Tv Klan	14	9	5
Vizion Plus	21	16	5
RTSH 1	7	5	2
News 24	22	16	6

Muaji Korrik 2024

Televizionet	Numri I kronikave të zeza me impact ndjeshëm në publik	Teksti – I informacioni I kronikës + sinkroni (me përmbajtje dhune- ndikuese	Imazhe audio-vizuale (me përmbajtje ndikuese
Top Channel	16	10	6
Tv Klan	15	10	5
Vizion Plus	18	13	5
RTSH 1	6	4	2
News 24	19	13	6

Muaji Qershor 2024

Televizionet	Numri I kronikave të zeza me impact ndjeshëm në publik	Teksti – I informacioni I kronikës + sinkroni (me përmbajtje dhune-ndikuese	Imazhe audio-vizuale (me përmbajtje ndikuese

Top Channel	13	8	5
Tv Klan	9	5	4
Vizion Plus	15	9	6
RTSH 1	4	2	2
News 24	14	9	5

Disa konkluzione dhe sugjerime

Mediat audiovizive dhe, posaçërisht, kanalet televizive përmbajnë element të konsiderueshëm të dhunës në programacionin e tyre. Dhuna në television është një çështje po aq e vjetër dhe e diskutueshme sa edhe krijimi i televizionit si medium masiv. Edhe pse epërsinë ndaj mediave e kanë marrë rrjetet sociale dhe platformat online, televizioni mbetet një medium me ndikim të fortë tek publiku në Shqipëri, aq më shumë kur bëhet fjalë për transmetimet e konvergjuara në platforma online ku është përqëndruar më së shumti rinia si *tik-tok, youtube* etj.

Problematike paraqitet realiteti mediatik i përcjellë nga edicionet e lajmeve ku përmbajtja dhe pamjet filmike të kronikave të zeza transmetojnë dhunë. Përmbajtje të caktuara audiovizive që lidhen me lajmet, kronikat e zeza veçanërisht me imazhe të rënda, detajeve për dhunën dhe vrasjet e grave, vajzave; studio me tematika politike me gjuhë urrejtje, emisione, filma-telenovelat, videoklipet e këngëve, duhet të transmetohen në mënyrë të reduktuar dhe me shenjat paralajmëruese të efekteve intensive ndikuese tek shikues të moshave të caktuara. Fenomeni paraqitet me pasoja të dëmshme, kryesisht te fëmijët, shtresat vulnerabël si njerëzit më sëmundje të shëndetit mendor dhe kategori të tjera. Grupe të caktuar të publikut, vetë ekspertët e komunikimit dhe organizatat për mbrojtjet e të drejtave të njeriut kanë reaguar të shqetësuar për dhunën në përmbajtjet televizive dhe ata kërkojnë një, qasje profesionale, vetërregulluese dhe trajtime brenda parimeve të Kodit të transmetimit të këtyre çështjeve.

Media duhet të promovojë programe që rrisin ndërgjegjësimin dhe edukimin mbi çështjet e dhunës dhe gjuhës së urrejtjes në media, duke adresuar nevojat e publikut. Mediat audiovizive duhet t'i referohen në mënyrë edhe më rigoroze parimeve të Kodit të transmetimit për dhunë në përmbajtjet televizive dhe Autoriteti i mediave audiovizive AMA, përmes Këshillit të ankesave, duhet të zhvillojë një qasje më sanksionuese në rastet e

transmetimit të një dhune flagrante të fëmijët gratë dhe kategoritë e brishta të publikut. Nga ana tjetër, nevojiten studime të thelluara dhe plane të organizuara veprimi me metodave të kërkimit shkencor nga AMA, vetë mediat audiovizive, universitetet, ekspertët e shëndetit mendor dhe shoqëria civile, përmes monitorimit të përmbajtjeve dhe anketimeve online, zhvillimit të konferencave dhe forumeve të ndryshme, që do të kontribuojnë në përmirësimin e realitetit mediatik.

Implementimi i konventave ndërkombëtare për këtë çështje, përmes hartimit të manualeve dhe udhëzuesve të veçantë, në bashkëpunim me ekspertë të mediave dhe të të drejtave të njeriut, do të ishte një nga hapat për një zgjidhje të pajtueshme të çështje së dhunës në përmbajtjet televizive.

Referencat

I.

- Appel, M. (2008). Fictional narratives cultivate just-world beliefs. *Journal of Communication*, 58(1), 62–83. <https://doi.org/10.1111/j.1460-2466.2007.00374.x>
- Bourdieu, P. (1996) *Sur la télévision et Le champ journalistique* , Collège de France, Paris.
- Bushman, B. J., & Anderson, C. A. (2015). Understanding Causality in the Effects of Media Violence. *American Behavioral Scientist*, 59(14), 1807-1821. <https://doi.org/10.1177/0002764215596554>
- Cardell, Sarah. (2007) *'Is quality television any good?'*, London and New York: I.B.Tauris.
- Foucaut AM, Faure C, Julia C, Czernichow S, Levy R, et al. (2019) *Sedentary behavior, physical inactivity and body composition in relation to idiopathic infertility among men and women.* PLOS ONE 14(4): e0210770. <https://doi.org/10.1371/journal.pone.0210770>
- Gerbner, G., Gross, L. (1976) Living with Television: The Violence Profile, *Journal of Communication*, Volume 26, Issue 2, June Pages 172–199, <https://doi.org/10.1111/j.1460-2466.1976.tb01397.x>
- Nicastro M. (2019) *La resistenza della scrittura. Letteratura, psicoanalisi, società*, Ladolfi Editore.
- Schwaab, H. (2013). 'Unreading' contemporary television. In M. de Valck & J. Teurlings (Eds.), *After the Break: Television Theory Today* (pp. 21–34). Amsterdam University Press. <http://www.jstor.org/stable/j.ctt46mv1q.4>
- Stanley, B. & Dennis, D. (1995) *Mass communication theory: foundations ferment and future.* Wads worth publishing company, California.
- Van den Bulck, J. (2004). The relationship between television fiction and fear of crime - An empirical comparison of three causal explanations. In *European Journal Of Communication* (Vol. 19, Number 2, pp. 239–248). SAGE Publications. <https://doi.org/10.1177/0267323104042922>

Violence, American Behavioral Scientist, 59(14)

II.

<https://ama.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/AMA-Kodi-I-Transmetimit.pdf>

<https://www.cambridge.org/core/journals/psychiatric-bulletin/article/media-for-mental-health/ABE28A2EC508205BCE3CDAE1C458B945>

https://www.gadc.org.al/media/files/upload/Dhuna_ne_familje_ne_fokusin_e_medias.pdf

<https://www.youtube.com/watch?v=3liAbNjNPCg>